

DPK/DMP

03-4398/12

02

07-12-2012

GJL nr.1349//2012

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Xhevat Bislimi, nga fsh. Verban K. Viti, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Viti, Regj.I.nr.3448/2012, të dt. 25.09.2012 e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me 22.11.2012, nxjerr:

## **A K T V E N D I M**

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Viti, Regj.I.nr.3448/2012, i dt 25.09.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Viti, me aktvendimin Regj.I.nr.3448/2012, të dt.25.09.2012 të pandehurin Xhevat Bislimi, nga fsh. Verban K. Viti, e ka shpallë përgjegjës sepse si Zyrtar i Lart në pozitën e Këshilltarit të Asamblesë Komunale të KK Viti, nuk ka përmbush obligimin ligjor që parashihet me Ligj, për deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar, edhe pse këtë deklarim ka qenë i detyruar ta bëjë brenda afatit të caktuar ligjor prej 01.03.2012 gjerë më 31.03.2012, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 17 par. 1 e sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publike dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr. 04/L-050, për të cilën kundërvajtje,ia shqiptoi gjobën në shumë prej 1.000€. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5€

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur i pandehuri Xhevat Bislimi, për shkak të: konstatimit jo të drejtë e jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënim, më tutje në arsyetim pasi e përshkruan pjesën dërmuese të dispozitivit të aktvendimit të shkallës së parë ndër të tjera thekson: se nuk i është dorëzuar atij personalisht formulari për deklarimin e pasurisë, se të njëjtin e ka pranuar dikush tjetër ndërsa kjo nga gjykata nuk është marrë parasysh se formulari për deklarim pasurie është i një rëndësie të madhe dhe është dashur që atij personalisht ti dorëzohet e jo të nënshkruhet në shitore apo gjetiu në emër të tij si në këtë rast, se është luftëtarë i denjë kundër dukurive negative siç është korrupsioni, se formulari i njëjtë ka mundur ti dorëzohet në lokalet e komunës së Vitisë, ku aty është për çdo ditë por pas këtij fakti mëshifen disa fërkime ndërpartiake, se nga të lartcekurat ky është dashur të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi pasi që qëllimi i dënimit është përmirësimi-risocializimi i të pandehurit, andaj nga të lartcekurat kërkon që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ose i njëjti të ndryshohet dhe ky të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi.

2.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, ankesën e paraqitur e aprovoi si të bazuar, e duke e shqyrtuar lëndën edhe sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 219 të Ligjit për Kundërvajtje aktvendimin e goditur e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljes së dispozitave esenciale të procedurës kundërvajtëse me pasojë vërtetimit e gabuar të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën dhe ka nxjerrë aktvendim në kundërshtim me kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e AKK-së, e ngarkon të pandehurin për mos deklarim të pasurisë nga neni 5 neni 6, par.1.3 dhe nga neni 9 të Ligjit 04./L-050, dhe në përshkrim të kundërvajtjes i propozon gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të ndëshkohet sipas nenit 17 par.1.3 të njëjtit Ligj, nga kjo rezulton se kërkesa e AKK-së të pandehurit i ngarkon kundërvajtjen për mos **deklarim të pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë**, neni 6 par.1.3 neni 9 i të njëjtit Ligj sqaron se i pandehuri nuk ka vepruar për të deklaruar pasurinë sipas kërkesës së Agjencisë, ku propozohet që ti shqiptohet dënimi sipas nenit 17 par.1.3 të njëjtit Ligj, ndërsa i pandehuri është shpallur përgjegjës për **“mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë në AKK deri më datën 31.03.2012”**, në vështrim të nenit 5.1.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 par.1 pika 1 të Ligjit 04/L-050, e që është në kundërshtim me atë për çka e ngarkon kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Në plotësim të procedurës, gjykata e shkallës së parë duhet të veproi sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të gjetura si më lart nga Kolegji dhe të merr në pyetje përfaqësuesin e ushtruesit të kërkesës i cili ( bazuar në kërkesën e ushtruar ) duhet të dëshmoi se cilat janë shkaqet që është kërkuar nga i pandehuri që të bëjë deklarimin e pasurisë si në vështrim të nenit 6 par. 1.3, neni 9 dhe neni 17 par.1.3 të Ligjit nr. 04/L-050, pasi që kërkesa e tyre nuk ka përshkrim të kundërvajtjes me fjalë ashtu siç është e paraparë me nenin 135 pika 2 të Ligjit për Kundërvajtje. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të këtyre provave dhe provave tjera eventuale të nevojshme e duke i pasur parasysh edhe thëniet në ankesën e paraqitur nga i pandehuri, varësisht prej vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerr aktvendim të drejtë të bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,  
GJL.nr.1349/2012, dt. 22.11.2012.

SEK. JURIDIKE  
Ganimete Dumani

KRYETARI I KOLEGJIT  
Ragip Namani